



Prishtinë, 16 maj 2014
Kodi i ZRRE:V_630_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Nenin 23 paragrafi 6 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Vendimin e Bordit të ZRRE-së: V_581_2013 të datës 08.11.2013 dhe V_605_2013 të datës 27.12.2013;
- Procedurën për lexim dhe faturim të konsumatorëve;
- Kërkesën të datës 02.05.2014 për aprovimin e faturës dhe kërkesën e KEDS-it të datës 02.04.2014, për plotësim/ndryshimin e faturës së energjisë elektrike me pajisje të dorës në Distriktin e Ferizajit (pilot projekti).

në mbledhjen e mbajtur më datë 16 maj 2014 e nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET** kërkesa e KEDS-it për aprovimin e faturës së gjeneruar me pajisje të dorës e cila do të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës me plotësim/ndryshimet e kërkuara nga KEDS-i.
- II. APROVOHET** amandamenti i nenit 16 paragrafi 1 i Rregullës për Shkycje dhe Rikycje të konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, që do të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- o ZRRE me datë 02.05.2014 ka pranuar nga KEDS-i kërkesën për aprovim të faturës së energjisë elektrike e gjeneruar përmes pajisjes së dorës dhe e cila do të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Kjo kërkesë e KEDS-it ka ardhur pasi që leximi dhe faturimi i njehsorëve do të bëhet me pajisje të dorës sipas procedurës aktuale të leximit dhe faturimit të konsumatorëve tarifor. ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e KEDS-it që leximi dhe faturimi do të realizohet me pajisje të dorës sipas procedurës aktuale të leximit dhe faturimit dhe vlerëson se kjo metodë e leximit dhe faturimit është në të mirë të konsumatorëve pasi që përveç tjerash do të minimizoj gabimet në lexim dhe se fatura e energjisë elektrike do t'i dorëzohet konsumatorëve në momentin e leximit të njehsorit elektrik.
- o ZRRE me datë 02.04.2014 ka pranuar nga KEDS-i kërkesën për plotësim/ndryshimin e faturës së energjisë elektrike me pajisje të dorës, e cila faturë do të përmbajë edhe disa elemente shtesë, si: mundësinë e pagesave të faturave përmes Bankave të Kosovës; pjesën e njoftimit për shkycje në



faturë duke përfshirë vetëm konsumatorët të cilët kanë borxh të papaguar të energjisë elektrike; dhe pjesën e njoftimit për mos qasje në pikën matëse (për rastet kur kjo zbatohet).

- o Kërkesa e KEDS-it që në faturën e energjisë elektrike të gjeneruar me pajisje të dorës të përfshihet edhe mundësia e pagesës përmes Bankave të Kosovës ka ardhur si rrjedhojë e kërkesës e cila i është bërë KEDS-it nga Banka Qendrore e Kosovës. Banka Qendrore e Kosovës ka kërkuar që fatura e energjisë elektrike të përmbajë edhe mundësinë e pagesës përmes Bankave të Kosovës. ZRRE pas vlerësimit të kësaj kërkesë ka vendosur që e njëjta të aprovohet duke pasur parasysh edhe interesin e konsumatorëve përmes së cilës konsumatorëve do t'iu lehtësohet mënyra e bërjes së pagesave edhe nëpërmjet bankave, pasi që e njëjta mundësi e pagesës është e lejuar edhe me faturat ekzistuese të distrikteve tjera.
- o Sa i përket kërkesës së KEDS-it që fatura e energjisë elektrike e gjeneruar me pajisje të dorës të përmbajë edhe njoftimin për shkyçje të konsumatorëve, ZRRE pas vlerësimit të kësaj pike ka vendosur që të amandamentojë nenin 16, paragrafi 1 të Rregullës për shkyçje dhe rikyçje të konsumatorëve në sektorin e energjisë, e cila dispozitë do të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe do të ketë përmbajtje: *“Pas kalimit të afatit përfundimtar të përcaktuar në njoftimin paralajmërues sipas Nenit 15, paragrafi 2, dhe duke marrë parasysh afatin kohor për zgjidhjen e kontestit të përcaktuar në Nenin 19, ndërmarrja e energjisë është e obliguar të dërgojë te konsumatori një njoftim për shkyçje **me faturë** para se të ndërmarrë veprimin për shkyçje për këto raste.”*

Duke pasur parasysh që njoftimi për shkyçje do t'i dorëzohet konsumatorit në momentin e leximit dhe faturimit të njehsorit, ZRRE vlerëson se aprovimi i kësaj kërkesë do të jetë në të mirë të konsumatorëve pasi që do të mund të vërtetohej saktë dërgimi i njoftimit për shkyçje te konsumatorët. Gjithashtu kjo do të ndikon edhe në zvogëlimin e shpenzimeve të ndërmarrjes e cila do të reflektohej edhe në tarifat e energjisë elektrike për konsumatorët.

- o Kërkesa e tretë e KEDS-it ka të bëjë që fatura e energjisë elektrike e gjeneruar me pajisje të dorës të përmbajë edhe njoftimin për mos qasje në pikën matëse, me arsyetimin se punëtorët e KEDS-it te disa konsumator po hasin në vështirësi për shkak të mos qasjes në pikën matëse. ZRRE pas shqyrtimit ka vendosur të aprovojë kërkesën e KEDS-it, pasi që sipas nenit 20 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, konsumatorët janë të obliguar t'i lejojnë qasje punëtorëve të autorizuar të ndërmarrjes së energjisë në pikën matëse për lexim, në të kundërtën mund të shkyçen nga rrjeti elektrik. ZRRE vlerëson se përmbajtja e këtij njoftimi në faturë do të ndikonte pozitivisht te konsumatorët, pasi që të njëjtit do të jenë të informuar për pasojat e mos qasjes në pikën matëse, si dhe për ofrimin e qasjes në pikën matëse sipas të dhënave në faturë. Ashtu siç u theksua më lartë ZRRE kërkon nga KEDS-i që në rastet e mos qasjes së leximit në pikat matëse, konsumatorët nuk duhet të shkyçen para tre periudhave të leximit. Pra, teksti i cili do të paraqitet në faturë duhet të ketë këtë përmbajtje: *“Punëtorët e autorizuar të KEDS nuk kanë pasur qasje për të lexuar dhe të inspektuar njehsorin tuaj, andaj ju lutemi që të siguroni qasje në leximin e ardhshëm me datën xx.xx.xxxx, në të kundërtën mund të shkyçeni nga rrjeti elektrik”.*

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



IV. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE

Enver Halimi, Kryesues

Merita Kostari, Anëtare

Krenar Bujupi, Anëtar